

**PhD Cand. Naile Demiri\***

**PhD Cand. Gazmend Abrashi<sup>Y</sup>**

## **Gazetari i medieve lokale përballë gazetarit të medieve kombëtare dhe ndërkombëtare**

### **Abstrakt**

Vështirësitë me të cilat përballen gazetarët e medieve lokale janë shumë më të mëdha, në krahasim me gazetarët të cilët punojnë në medien kombëtare apo edhe në ndërkombëtare. Ka shumë faktorë që e rëndojnë punën dhe funksionimin e mirëfilltë të medias lokale. Në fushë-studimin tonë, jemi dëshmitarë se të rralla janë ato mediume televizive që i përmbahen etikës së mirëfilltë gazetareske. Duke mos dashur të bëjmë përgjithësime, por fatkeqësisht, një numër i madh i mediume lokale varen apo funksionojnë në mënyrë —ditatoriale”, ku pronari e dikton politikën editoriale të mediumit, apo, për të mos thënë që ai është personi që vendos çka të editohet apo të transmetohet, gjë që e rëndon funksionimin e mirëfilltë të mediumit.

Duke u nisur nga vetë emri media lokale, na krijohet perceptcioni se janë mediat e një regjioni të caktuar dhe funksionojnë dhe veprojnë duke e pasqyruar realitetin e atij regjioni. Mirëpo, shumica e mediale lokale tek ne, hapësirën kryesore editues e mbulojnë me ngjarje të nivelit kombëtar dhe ndërkombëtar, duke i anashkaluar

---

\*Kolegji AAB, Email: [naile.demiri@aab-edu.net](mailto:naile.demiri@aab-edu.net),

<sup>Y</sup>Kolegji AAB, Email: [gazmend.abrashi@aab-edu.net](mailto:gazmend.abrashi@aab-edu.net),

problemet dhe aktualitetin e atij regjioni, pra mund të thuhet se bëjnë një zhvendosje të vëmendjes të audiencës lokale.

Nëse e bëjmë një analizë se si është sot gazetari lokal **përballë gazetarit të medieve kombëtare dhe ndërkombëtare**, atëherë mund të themi se kemi gazetarë të cilëve u mungon formimi profesion për profesionin të cilin e ushtrojnë, por, edhe pse në raste më të rralla, kur kemi ndonjë gazetar që ka formimin universitar për profesionin e gazetarit, ai duhet të punojnë në bazë të direktivave të pronarit të medias. Këtë më së miri e ilustron gazetar i TV Besa të Prizrenit, i cili ditë më parë iu qas një padrejtësie që u zhvillua në Drejtorin e Arsimit të Prizrenit, porse padroni e shtyri të tërhiqet, sepse mund të kishte komplikime në vazhdimin e marrjes së reklamave nga Komuna e Prizrenit.

**Fjalët kyçe: gazetari, media, reklama, lokale, ndërkombëtare, audiencë**

### **Mediet lokale në Kosovë**

Pas përfundimit të luftës dhe me fillimin e sistemit demokratik në Kosovë, filluan të funksionojnë shumë medie lokale dhe kombëtare. U krijuam mekanizma të mbikëqyrjes dhe të rregullimit frekuencor, po ashtu edhe operatorë për shpërndarjen e sinjalit audio-vizuel. Synimi kryesor i tyre ishte të jepnin ndihmën në konsolidimin dhe në funksionimin sa më të mirë të medieve në Kosovë, gjithnjë duke e pasur si qëllim se me medie të lira dhe të pavarura krijohen kushtet dhe premisat për demokratizimin e shoqërisë. Po ashtu u themelua, Rrjeti Tokësor i Transmetimit të Kosovës (RRTTK), që ofron shërbime transmetimi për nevojat e 4 televizioneve nacionale dhe 52 lokale - të cilët operojnë duke përdorur pika-rrjete transmetuese private dhe, së bashku, ato mbulojnë 68.14% të territorit të Republikës.<sup>1</sup>

Nga të dhënat e siguruar nga Komisioni i Pavarur për Media, shohim se kemi një numër të madh të medieve elektronike lokale, si

---

<sup>1</sup>[www.kpm-ks.org/materiale](http://www.kpm-ks.org/materiale), shikuar më: 04.12.2016, në ora 15:00.

radio, po ashtu edhe televizione, në raporte me numrin e popullsisë së atij regjioni. Shpërndarja e tyre kaq e madhe ka ndikuar që niveli i profesionalizmit dhe serioziteti i tyre të vihet në pikëpyetje. Kjo edhe për shkak të mundësive financiare, të cilat i kanë të kufizuara, dhe ballafaqohen me ekzistencën e tyre, si dhe nuk kanë ndonjë plan për zhvillim dhe kalimin në strategjinë zhvillimore.

Problematikë më vete tek mediet lokale vazhdon të jetë mbulimi i ngjarjeve nacionale në programin e tyre, duke harruar se target i tyre është publiku lokal. Kjo dukuri shfaqet më shumë në edicionet e lajmeve, apo siç njihet, e bëjnë gazetarinë protokollare dhe nuk iu qasen problematika specifike të atij regjioni, gjë që do të rriste edhe shikueshmërinë e tyre. Por, nga ana tjetër, ky është një tregues për shkallën e zhvillimit të tyre dhe qëndrueshmërinë financiare.

### **Ambienti punues në mediet lokale**

Nga një vështrim i përgjithshëm mund të konstatojmë se ekziston një numër shumë i vogël i të punësuarve në mediet lokale. Siç e kemi potencuar edhe më lart, duhet të bëhet një planifikim dhe një shpërndarje e frekuencave në bazë të madhësisë së regjionit duke filluar nga numri i banorëve. Duke i parë këto të dhëna, mund të planifikojmë se çfarë mediash i duhen regjionit në fjalë, sa mund të jetë numri i tyre, gjithnjë duke e pasur parasysh edhe faktorin ekonomik, që në rastet e tilla është vendimtar për hapjen dhe funksionimin e një medie.

Kur themi ambienti punues, e kemi fjalën për angazhimin e stafit profesional gazetaresk, po ashtu edhe atij teknik, burimet njerëzore të cilat angazhohen: a kanë kontrata pune apo vetëm angazhohen me kontratë mbi vepër, sa ju përmbahen pronarët e medieve kryerjes së detyrimeve, si mujore, po ashtu edhe pensionale, tatimore, ndaj të punësuarve, apo ende kemi medie të cilat punojnë në mënyrë klandestine?

Faktori ekonomik tek mediet lokale ka shumë ndikim, pasi ekonomia në Kosovë është zhvilluar në mënyrë disproporcionale, disa sektorë janë rritur shumë më shumë sesa tjerët. Sistemi bankar dhe telekomunikacioni janë në majë të listës. Për shkak të natyrës së

këtyre bizneseve, si dhe konkurrencës agresive në secilin prej këtyre dy sektorëve, është shumë e natyrshme që ato të bazohen shumë tek reklamimi, për ta ruajtur dhe për ta zgjeruar bazën e tyre të konsumatorëve.<sup>2</sup>

Si rezultat, dy sektorët janë reklamuesit më të mëdhenj në sektorin privat. Bankat në veçanti dhe kompanitë e telekomunikacionit në masë të madhe rrallë i nënshtrohen kritikave në media. Një prej zyrtarëve të lartë ekzekutivë në një bankë të madhe që vepron në nivel ndërkombëtar, përshkruante strategjinë e thjeshtë, e cila u vërtetua si e suksesshme, pas shpenzimit të kohës dhe parave në përpjekje tradicionale të marrëdhënies me publikun: banka thjesht e rrit hapësirën reklamuese në një medium të caktuar në një kohë të caktuar, duke bërë rotacionin me kujdes ashtu që të gjithë të mbesin të kënaqur.<sup>3</sup>

### **Politika editoriale tek mediet lokale**

Nga vrojtimi i medieve lokale, të dhënat na tregojnë se interesat e pronarit dhe përkatësia politike janë faktorët kyçë në përcaktimin e politikës dhe qëndrimit editorial të medias. Ndikimi kaq i madh i këtyre faktorëve mund të shpjegohet me gjendjen financiare të medieve, gjë që identifikohet si e zakonshme, posaçërisht në mediet lokale. Një klimë mediatike, me një treg të vogël reklamash, ku mediat përdoren për të mbështetur interesat ekonomike, jomediatike të pronarëve të medias, rëndësia apo cilësia e lajmit nuk mund të kenë të njëjtën peshë në formësimin e politikës editoriale.

*Kodi i Etikës ka për qëllim përcaktimin e rregullave të etikës për ofruesit e shërbimeve mediale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike; në pajtim me parimet etike, standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe respektin ndaj diversitetit të trashëgimisë etnike, kulturore dhe fetare në Republikën e Kosovës; për interesa të sigurisë kombëtare, të integritetit*

---

<sup>2</sup><http://www.osce.org/sq/kosovo/122391?download=true>. shikuar më 07.12.2016, në ora 20:00.

<sup>3</sup> Po aty.

*territorial dhe të sigurisë publike; për parandalimin e trazirave dhe të krimit; për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut; për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, për mbrojtjen e fëmijëve, për mbrojtjen e prestigjit dhe të drejtat e të tjerëve, për parandalimin e zbulimit të informatave të dhëna në besim, për ruajtjen e autoritetit dhe paanësisë.<sup>4</sup>*

Deri më tani e elaboruam çështjen e presioneve dhe ndikimit nga politika të medias, por, të jemi realistë, duhet ta shikojmë edhe anën tjetër, pra të medias që u bënë lajka dhe favore zyrtarëve shtetërorë, për interesa të caktuara private dhe biznesore. Ka gjithashtu pak raste kur lajkat për zyrtarët në pushtet bëhen si shërbime ndaj ambicieve politike të vetë pronarëve.

Pra, nga raporti i marrëdhënies pronar - politikan, humbësi i vetëm është publiku - opinionioni, i cili keq informohet, pikërisht nga njerëzit të cilët janë në krye të këtyre institucioneve, që janë të thirrur për të qenë në shërbim të qytetarëve. Që e bëjnë pikërisht të kundërtën e asaj se çfarë funksioni kanë në shoqëri dhe nga kjo gjendje krijohen shumë mjegullësi në pasqyrimin e gjendjes reale në atë vend. Sepse, nuk është e thënë kot, nëse ndonjë ngjarje nuk pasqyrohet në media, ajo ngjarje mund të llogaritet si e paqenë!!

### **Stabiliteti financiar i medias lokale**

Duke funksionuar në një hapësirë dhe treg të kufizuar dhe me një zhvillim të ngadaltë ekonomik, mediet e kanë shumë të vështirë të jenë indiferente ndaj presionit të institucioneve dhe të biznesit, për shkak se janë të varura në masë shumë të madhe nga hapësira reklamuese të cilën e kanë në kanalet e tyre.

Në nivel ndërkombëtar, në vitin 2010, Reporterit i Posaçëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UN) mbi Lirinë e Opinionit dhe të Shprehjes, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Përfaqësuesi për Lirinë e Medias, Reporterit i Posaçëm mbi Lirinë e Shprehjes i Organizatës së Shteteve Amerikane (OAS) dhe Reporterit i Posaçëm mbi Lirinë e Shprehjes dhe Aksesit të

---

<sup>4</sup><http://kpm-ks.org/?mod=dokumentet&faqja=2&gjuha=1>; kodi i etikës; shikuar më 09.12.2016, në ora 18:00.

Informacionit të Komisionit Afrikan mbi Të Drejtat e Njeriut (ACHPR), miratuan më 3 shkurt 2010 *Deklaratën mbi Dhjetë Kërcënimet Kyçe ndaj Lirisë së Shprehjes*. Në mënyrë domethënëse, një prej tyre është presioni tregtar mbi median, që ndikon mes të tjerash në rritjen e përqendrimit të medias.<sup>5</sup>

Kështu, sipas Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës CM/Rec(2007)2 *Mbi pluralizmin e medias dhe larmishmërinë e përmbajtjes së medias*, shteti duhet të miratojë rregulla që synojnë të —kufizojnë ndikimin e një personi të vetëm, kompanie apo grupi mbi një apo më shumë sektorë të medias, si dhe të sigurojnë praninë e një numri të mjaftueshëm entesh të larmishme mediatike”.<sup>6</sup>

Sipas Rekomandimit, rregullat duhet të jenë të qarta për mënyrën e financimit dhe funksionimit të medieve në përgjithësi, por ne duhet të bëjmë një shkëputje pasi që tema është për mediet lokale, ku mundësia dhe rastet e kontrollit financiar ndaj medieve janë më prezente, si në hapësirën reklamuese, pra nga bizneset, po ashtu edhe nga kapitali fillestar i hapjes së medies.

### **Sfidat e gazetarëve të medieve lokale**

Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat me të cilat ballafaqohen gazetarët, si nga brenda mediumit po ashtu edhe nga faktorët e jashtëm që ndikojnë në punën e tyre, një element shumë i rëndësishëm e të cilin nuk e elaboruam shumë, është edhe niveli profesional i gazetarëve lokalë. Prapë në këtë aspekte jemi të kufizuar, pasi që nuk kemi shifra dhe të dhëna të sakta për nivelin e shkollimit profesional të gazetarëve lokalë. Po t'i kishim këto të dhëna, panorama dhe ideja për medien lokale do të ishte e plotë.

Mungesa e trajnimeve dhe rifreskimi i teknikave dhe zhanreve të gazetarisë, dhe të mosqenurit në hap me zhvillimet teknologjike, ka ndikuar që mediet lokale në vendin tonë të jenë në gjendje jo të kënaqshme, si në aspektin profesional ashtu edhe atë ekonomik, gjë

---

<sup>5</sup><http://www.osce.org/fom/41439>

<sup>6</sup>Po aty, fq.18.

që ndikon edhe në punën dhe vullnetin për punë të gazetarëve, sepse mund të veçohen disa gazetarë të cilët janë profesionalë dhe entuziastë, por kur nuk është ambienti punues kompetitiv për ide të reja, dhe nuk ka punë ekipore për të arritur rezultate sa më të larta, edhe vullneti për punë profesionale dhe kreative bie, gjë që është edhe e natyrshme.

Në këtë punim më shumë e elaboruam aspektin profesional dhe ekonomik të medieve lokale, por temë më vete është edhe qasje dhe sfidat që hasin gazetarët lokalë për qasjen në dokumentet lokale, si dhe qasje dhe mbulimi i ngjarjeve në kuvendet komunale, në të cilat merren vendime për qytetarët e të cilët nuk janë të informuar.